

Si të regjistrohemi për DIVA?

Plotësimi dhe dorëzimi i dekarates individuale vjetore të të ardhurave DIVA kryhet vetëm në mënyrë elektronike,(për shtetasit shqiptarë dhe të huaj), nëpërmjet modulit e-filing në tatime.gov.al.


Për t'u regjistruar për DIVA, ndiqni hapat e mëposhtëm:

Regjistrimi i shtetasve shqiptarë:

1. Në faqen zyrtare te internetit te Administrates Tatimore: tatime.gov.al, klikoni në menune E-sherbime:



2. Zgjidhni rubriken Per individe



3. Dhe më pas klikoni ne linkun e evidentuar:



4. Plotësoni të dhënat personale në të gjitha fushat e Formularit që do t'ju shfaqet:

Shqip English

Ju lutemi, plotësoni të dhënat tuaja personale

Numri Personal *

Numri i Kartës së Identitetit *

Emri *

Atësia *

Mbiemri *

Mëmësia *

Data e Lindjes *

Zyra Tatimore *

Adresa e Postës Elektronike (e-mail) *

Numri i Telefonit

Password *

Confirm Password *

Fjalëkalimi duhet të plotësojë kushtet më poshtë:

1. Duhet të jetë të paktën 8 karaktere i gjatë
2. Duhet të përmbajë të paktën një numër.
3. Duhet të përmbajë të paktën një gërmë kapitale dhe një jo-kapitale.

E lexova dhe bie dakord me [termat dhe kushtet](#)

Pasi jeni regjistruar, mund të hyni në eFiling!
Emri juaj i përdoruesit do të jetë numri juaj personal dhe fjalëkalimi juaj do të jetë fjalëkalimi që keni vendosur në këtë formë!

- Regjistrimi i shtetasve të huaj,(jorezidentë)

Për tu regjistruar, çdo individ i huaj (ose një person i autorizuar prej tij) duhet të paraqitet në zyrat e shërbimit të tatimpaguesve, ku do të pajiset me një numër identifikimi dhe fjalëkalimin përkatës.